



Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosovo  
Zyra e Kryeministrit-Ured Premijera-Office of the Prime Minister  
Zyra për Qeverisje ë Mirë/Kancelarija za Dobro Upravljanje/Office on Good Governance

## RAPORTI VJETOR



**PËR KONSULTIMET ME PUBLIKUN NË QEVERINË  
E REPUBLIKËS SË KOSOVËS PËR VITIN 2020**

Mars 2021

Përmbajtja

<a href="#">Lista e shkurtesave</a> .....	4
<a href="#">1. Hyrje</a> .....	5
<a href="#">2. Përmbledhje Ekzekutive</a> .....	7
<a href="#">3. Metodologjia e Raportimit dhe Monitorimit për Zbatimin e Standardeve</a> .....	09
<a href="#">4. Platforma Online për Konsultimet me publikun</a> .....	12
<a href="#">5. Bashkëpunimi dhe ngritja e kapaciteteve për konsultimet publike</a> .....	13
<a href="#">6. Numri i përgjithshëm i projekt dokumenteve</a> .....	14
<a href="#">8. Shkalla e plotësimit të standardeve minimale</a> .....	16
<a href="#">09. Metodatat e përdorura gjatë procesit të konsultimeve</a> .....	17
<a href="#">10. Numri dhe statusi i komenteve</a> .....	17
<a href="#">11. Sfidat gjatë vitit 2020</a> .....	21
<a href="#">12. Rekomandimet</a> .....	22
<a href="#">SHTOJCA I: Lista e dokumenteve të konsultuara gjatë vitit 2020</a> .....	21

## **Lista e Figurave**

Figura 1. Paraqitja grafike e statistikave sipas institucioneve qendrore.....	10
Figura 2: Numri i dokumenteve te konsultuara (2020).....	14
Figura 3: Numri i dokumenteve sipas kategorive (2020).....	15
Figura 4: Shkalla e plotësimit të standardeve.....	16
Figura 5: Numri dhe statusi komenteve (2020).....	18
Figura 6: Ndarja e dokumenteve sipas komenteve ne platforme.....	18
Figure 7: Komentet sipas ministrive.....	21

## **Lista e Tabelave**

Tabela 1: Përmbledhje e llojeve te dokumenteve te publikuara sipas institucioneve - Konsultat e mbyllura gjatë periudhës - Data: 01.01.2020-31.12.2020.....	09-10
Tabela 2:Metodat e konsultimit të përdorura sipas ministrive.....	17
Tabela 3: Përmbledhje e llojeve te dokumenteve te publikuara sipas aktivitetit te bashkepunetoreve Data: 01.01.2020-31.12.2020.....	19-20

## **Lista e shkurtesave**

ZKM	Zyra e Kryeministrit
ZQM	Zyra për Qeverisje të Mirë
KE	Komisioni Evropian
MPL	Ministria e Pushtetit Lokal
MASH	Ministria e Arsimit dhe Shkencës
MBPZHR	Ministria e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural
MD	Ministria e Drejtësisë
MF	Ministria e Financave
MM	Ministria e Mbrojtjes
MI	Ministria e Infrastrukturës
MKRS	Ministria e Kulturës Rinisë dhe Sporteve
MPB	Ministria e Punëve të Brendshme
MPMS	Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale
MPJD	Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës
MSH	Ministria e Shëndetësisë
MTI	Ministria e Tregtisë dhe Industrisë
MEA	Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit
MZHR	Ministria e Zhvillimit Rajonal
MKK	Ministria e Kthimit dhe Komuniteteve
SBS	Mbështetje Buxhetore Sektoriale (Sector Budget Support)

## 1. Hyrje

Hapja dhe transparenca e institucioneve për publikun është një nga faktorët kryesorë që ndikon në rritjen e llogaridhënjes së institucioneve por edhe performances më të mirë të vet administrates publike. Sistemi aktual i konsultimeve publike i themeluar në vitin 2016, tashmë është në një fazë stabiliteti të procesit të politikë bërjes dhe hartimit të legjislacionit në Qeverinë e Republikës së Kosovës. Ky proces po udhëhiqet dhe koordinohet nga Zyra për Qeverisje të Mirë/Zyra e Kryeministrit dhe po përkrahet nga koordinatorët për konsultimet me publikun në Zyrën e Kryeministrit, në Ministrinë e Linjës për të vazhduar edhe me nivelin lokal. Si rrjedhojë edhe plotësimi i standardeve të përcaktuara me Rregulloren nr.05/2016 për standardet minimale për konsultime me publikun, tashmë është bërë pjesë e punës së përditshme të institucioneve qeveritare.

Qeveria e Republikës së Kosovës përmes Zyrës për Qeverisje të Mirë në Zyrës së Kryeministrit ka arritur që në platformën online <https://konsultimet.rks-gov.net/> bashkë me ministrinë e edhe Komunitat, të publikojnë dhe ndajnë me OJQ-të e publikun dokumentet që janë hartuar dhe janë përcjellë për aprovim në qeveri dhe në kuadër të ministrive. Platforma ka qenë një dritare ku publikut dhe OJQ-ve i është ofruar qasje për përfshirje, informim dhe mundësi për të dhënë kontributin përmes komentimit dhe rekomandimeve për politikën dhe legjislacionin që është hartuar nga institucionet publike.

Kriza aktuale me pandeminë Covid19 gjatë vitit 2020, dhe e cila po vazhdon ende, por dhe ndërrimi i dy qeverive gjatë vitit 2020, patjetër që e kanë ngadalësuar dhe vështirësuar shumë procesin e politikë-bërjes e rrjedhimisht edhe konsultimit publik, duke përfshirë të gjithë hapat dhe mjetet për përfshirjen e OSHC-ve dhe publikut në politikëbërje, monitorimin e hartimit të legjislacionit e politikave deri te aprovimi i tyre në qeveri.

Sidoqoftë, përkundër situatës së krijuar me pandeminë e edhe asaj institucionale, Zyra për Qeverisje të Mirë / Zyra e Kryeministrit bashkë me koordinatorët kanë vazhduar të ofrojnë me kapacitet e tyre maksimale hapsirë për publikut për tu përfshirë në procesin e konsultimit publik. Përmes platformës online, Zyra për Qeverisje të Mirë së bashku me ministrinë kanë arritur të publikojnë dhe ndajnë me publikun dokumentet e planifikuara për t'u hartuar dhe përcjellë vazhdimisht edhe për miratim nga qeveria dhe ministrinë.

Zyra për Qeverisje të Mirë / Zyra e Kryeministrit duke filluar nga shtatori 2020, ka avancuar modalitetet në platformën për konsultime dhe përmes platformës, uebfaqes dhe rrjeteve sociale, ka zhvilluar dhe po zhvillon një fushatë informuese për Platformën Online për Konsultimet Publike dhe Standardet Minimale për përfshirjen e qytetarëve në politikë bërje dhe vendimmarrje. Është përgatitur një udhëzues për përdorimin e Platformës Online për Konsultimet Publike (tutorial) i cili u bën thirrje qytetarëve, përfaqësuesve të shoqërisë civile dhe publikut të gjerë që të përdorin Platformën Online për konsultime publike. Ky tutorial gjithashtu edhe e shpjegon se si shoqëria civile dhe publiku mund të përfshihen në platformë dhe të komentojnë. Kjo fushatë synon të rrisë ndërgjegjësimin e publikut mbi rëndësinë e përdorimit efektiv të Platformës Online për Konsultimet Publike, mbi forcimin,

qëndrueshmërinë dhe stabilitetin e sistemit të konsultimit publik dhe më e rëndësishmja përfshirjen e shoqërisë civile në politikë bërjen dhe vendimmarrje.

Krahas kësaj Zyra për Qeverisje të Mirë/Zyra e Kryeministrit si koordinatorë e procesit të konsultimeve me publikun në bashkëpunim me të gjitha ministritë e linjës përmes koordinatorëve për konsultime në ministrit të përfshirë në procesin e zhvillimit të politikave dhe legjislacionit, ka punuar në monitorim e zbatim të standardeve për konsultimet me publikun. Rrjedhimisht për monitorimin e zbatimit të Standardeve minimale për konsultimet publike, Zyra për Qeverisje të Mirë/Zyra e Kryeministrit gjatë gjithë kohës është duke punuar në ofrimin e një pasqyrimi për zbatimin e kriterëve të parapara për gjithë përfshirje me Rregulloren nr.05/2016 për standardet minimale për konsultime me publikun. Andaj në këtë dokument ofrohet pasqyrimi për vitin 2020 lidhur me zbatimin e standardeve për konsultimet të parapara me rregulloren për konsultimet me publikun.

Monitorimi i zbatimit të procesit të konsultimeve është edhe pjesë e Strategjisë Qeveritare për bashkëpunim me Shoqërinë Civile 2019-2023, si dhe pjesë e vlerësimit të Komisionit Evropian përmes marrëveshjes së Qeverisë dhe Komisionit Evropian për mbështetjen direkte buxhetore. Përveç shtrirjes në nivel qendror të qeverisë, sistemi i konsultimeve publike është zgjeruar edhe në të gjitha komunat si në aspektin rregullator ashtu edhe në krijimin e mjeteve dhe kushteve për zbatimin e tij d.m.th. të gjitha komunat janë pjesë e integruar e platformës për konsultimet me publikun. Mirëpo duhet theksuar se niveli lokal nuk është pjesë e fushëveprimit të këtij raporti edhe këtë vit, sepse janë vetëm disa komuna që kanë filluar të publikojnë dokumente për konsultimet me publikun në platformën për konsultime dhe emërimi i koordinatorëve për konsultime në nivelin lokal është ende në proces. Janë trembëdhjetë(13) koordinatorë deri tani që janë emëruar nga niveli lokal dhe vetëm Komuna e Rahovecit e cila ka publikuar dokumente për konsultimet me publikun në platformën online.

## 2. Përmbledhje Ekzekutive

Në pajtim me Rregulloren nr. 05/2016 për Standardet Minimale për Konsultimet me Publikun, Zyra për Qeverisje të Mirë/Zyra e Kryeministrit udhëheqë dhe është përgjegjëse për hartimin e Raportit Vjetor për Konsultimet Publike të zhvilluara nga të gjitha ministrinë dhe Zyra e Kryeministrit. Në përputhje me kërkesat e Rregullores, Zyra për Qeverisje të Mirë/Zyra e Kryeministrit, në bashkëpunim me të gjitha ministrinë dhe institucionet tjera të përfshira në procesin e zhvillimit të politikave dhe legjislacionit për të katërtin vit me radhë ka përgatitur raportet vjetore për konsultimet me publikun.

Raporti vjetor për vitin 2020 do të përfshijë të gjitha dokumentet që janë publikuar në platformën për konsultimet me publikun e për të cilat konsultimi ka filluar nga data 01.01.2020 dhe është mbyllur më datë 31.12.2020. Raporti ka qëllim të paraqesë punën e bërë gjatë vitit 2020 në zbatimin e standardeve minimale për procesin e konsultimeve publike nga ana e Qeverisë dhe ministrive të linjës.

Raporti paraqet detajet dhe statistikat për plotësimin e të gjitha standardet që nga planifikimi, iniciimi dhe procesi i hartimit të dokumenteve, rrjedhës së konsultimit, hartimit të dokumentit të konsultimit, përdorimit të metodave të konsultimit përfshirë edhe platformën, pjesëmarrjen e publikut në ofrimin e kontributeve të tyre, statusin e komenteve etj.

Raporti paraqet në mënyrë të detajuar kategoritë e informatave si në vijim:

- **Numri i përgjithshëm i dokumenteve të hartuara dhe të konsultuara** - Nga fillimi i vitit 2020 deri në fund të vitit 2020 raportohet se janë hartuar 184 dokumente ku 181 dokumente kanë qenë për konsultim publik në platformën online dhe tri dokumente që janë aprovuar në qeveri e të cilat nuk kanë qenë të publikuara në platformën për konsultime. Prej 184 dokumenteve janë: 16 koncept dokumente, 44 draft ligje, 2 strategji, 4 programe, 6 plane veprimi, 42 draft rregullore dhe 70 udhëzime administrative.
- **Plotësimi i standardeve** - Prej 181(një qind e tetëdhjetë e një) dokumenteve të publikuara në platformë 115(një qind e pesëmbëdhjetë) prej tyre i plotësojnë standardet dhe 66(gjatë dhjetë e gjashtë) prej këtyre dokumente nuk i plotësojnë standardet. Tri dokumentet që janë jashtë platforme nuk i plotësojnë standardet për konsultim.
- **Plotësimi kriterëve të treguesve të SBS-it** - Vlerësimi për treguesit e SBS-it për plotësim të indikatorit 2 për konsultimet me publikun për vitin 2020 ka qenë 75%. Mirëpo këto caqe, për vitin 2020 janë shtyrë për t'u realizuar në vitin 2021, duke pasur parasysh se pandemia Covid19 ka ndikuar në mos mundësinë e realizimit të tyre. Gjithsesi vlen të përmendim se në kuadër të kornizës së kushteve të treguesit të SBS-it gjatë vitit 2020 janë konsultuar gjithsej 66(gjatë dhjetë e gjashtë)dokumente. Prej tyre 64 (gjashtëdhjetë e katër) dokumente janë konsultuar përmes

platformës: 15 (pesëmbëdhjetë) koncept dokumente, 44 (katër dhjetë e katër) projekt ligje, 3(tri) programe dhe 2(dy) strategji si dhe 2 (dy) dokumente që janë konsultuar jashtë platforme dhe janë aprovuar në qeveri ( një koncept dokument dhe një program). Nga 66(gjatë dhjetë e gjashtë) dokumente sa janë gjithsej: 16(gjashtëmbëdhjetë) koncept dokumenteve: prej tyre 09(nëntë) koncept dokumente i plotësojnë kriteret e konsultimit dhe 07(shtatë) nuk i plotësojnë kriteret, draft ligje: prej 44(katër dhjetë e katër) sa janë gjithsej në platformë: 29 (njëzete e nëntë) i plotësojnë standardet dhe 15(pesëmbëdhjetë) nuk i plotësojnë standardet e konsultimeve). Përlllogaritja për këto statistika është pa përfshirë vendimet e Qeverisë për dokumentet e konsultuara. Prej 4(katër) programeve: 1 (një) program i plotëson standardet e konsultimit dhe 3(tri) nuk i plotësojnë standardet. Ndërsa 2(dy) strategji nuk i plotësojnë standardet dhe kriteret e SBS.

- **Pjesëmarrja në proces të konsultimit dhe komentet**- Është raportuar se gjatë procesit të konsultimeve publike gjithsejtë kanë marrë pjesë 1021 pjesëmarrës. Nga këta pjesëmarrës gjithsejtë janë bërë 1898 komente qoftë përmes platformës, takimeve, grupeve të punës apo edhe me shkrim. Llogaritet se 961 komente janë pranuar plotësisht nga hartuesit e dokumenteve, 463 komente janë pranuar pjesërisht dhe 474 komente janë refuzuar apo nuk janë pranuar nga institucionet hartuese.
- **Metodat e përdorura të konsultimit** - Gjatë vitit 2020 në platformën për konsultimet me publikun janë publikuar 181 dokumente. Tri dokumente nuk janë konsultuar përmes platformës për konsultimet me publikun. Prej 181 dokumenteve 98 prej tyre janë konsultuar edhe përmes komunikimit zyrtar dhe 91 dokumente krahas platformës janë konsultuar edhe nëpërmes takimeve të punës, me shkrim, etj. Ndërsa 148 dokumente sipas raporteve kanë marrë kontribut apo janë komentuar nga publiku përmes komunikimit zyrtar dhe platformës.



### 3. Metodologjia e raportimit dhe monitorimit të zbatimit të standardeve

Edhe në vitin 2020 raportimi vjetor për rrjedhën e konsultimeve me publikun është bërë sipas metodologjisë së raportimit për rregulloren për konsultimet me publikun. Për përgatitje të raportit janë përdorur disa burime të informatave:

- Të gjitha të dhënat dhe informatat e përcjella nga koordinatorët e konsultimeve publike nga secila ministri dhe Zyra e Kryeministrit.
- Të dhënat e publikuara dhe të përditësuara nga platforma për konsultimet me publikun.
- Të dhëna tjera të cilat rrjedhin nga aktivitetet e Zyrës për Qeverisje të Mirë/Zyrës së Kryeministrit dhe projekteve të cilat e mbështesin Qeverinë në zhvillimin dhe avancimin e konsultimeve publike.

Kërkesës së Zyrës për Qeverisje të Mirë/Zyrës së Kryeministrit për raportim nga ana e ministrive të dërguar me datë 22 shkurt 2021 i janë përgjigjur 13 ministri prej 16 sa janë si dhe Zyra e Kryeministrit.

Ministria për Komunitetet e Kthim MKK nuk kanë dokumente të publikuara në platformën për konsultimet me publikun, ndërsa MPJD dhe MPB nuk i janë përgjigjur kërkesës për raportim. Të dhënat për këto ministri janë marrë direkt nga administratori i platformës. Krahas këtyre dokumenteve edhe Zyra e Presidentit të Republikës të Kosovës kanë të publikuar në platformën për konsultimet me publikun një dokument dhe Komuna e Rahovecit ka të publikuar në platformën pesë dokumente për konsultimet me publikun mirëpo këto të dhëna për Presidencën dhe Komunën e Rahovecit nuk janë të përfshira në këtë raport.

Raportimi nga koordinatorët është bërë përmes formularëve të dizajnuar për mbledhjen e informatave për hartimin e raportit vjetor sipas Rregullores dhe Metodologjisë së Monitorimit dhe Raportimit për zbatimin e standardeve minimale të miratuar nga ZKM në vitin 2017.

Gjithashtu pasi disa nga informatat e raportuara nga ministrinë nuk janë përputhur me ato që gjenden në platformë si dhe ministrinë që përmendën më lartë nuk kanë raportuar fare, atëherë informatat plotësuese janë marrë nga platforma elektronike për konsultimet publike.

Kriteret e vlerësimit sipas Rregullores për standardet minimale janë:

- Secili dokument i konsultuar duhet të ketë planin e konsultimit.
- Dokumentin e konsultimit së bashku më dokumentin themelor i cili konsultohet duhet të jetë i publikuar në platformën elektronike për konsultimet publike.
- Afati i konsultimit duhet të jetë së paku 15 ditë punë.
- Raporti i konsultimit duhet të jetë i publikuar në platformë për secilin dokument të konsultuar.

- Dokumenti themelor i konsultimit të jetë i publikuar pas përfshirjes së komenteve dhe propozimeve.

*Tabela 1. Përmbledhje e llojeve të dokumenteve të publikuara sipas institucioneve - Konsultat e mbyllura gjatë periudhës - Data: 01.01.2020-31.12.2020*

Përmbledhje e llojeve të dokumenteve të publikuara sipas institucioneve - Konsultat e mbyllura gjatë periudhës - Data: 01.01.2020-31.12.2020										
Institucion i / Tipi dokumenti	Koncept dokument	Draft ligj	Plan i veprimit	Draft rregullore	Udhëzim administrativ	Strategji	Program	Tjetër	Totali	Ne përfaqësojnë raport me të gjitha IRK-te
Zyra e Kryeministrit	2	2	2	2	3	1	3	0	15	8.29%
Ministria e Kulturës Rinise dhe Sportit	1	3	0	3	1	1	0	0	9	4.97%
Ministria e Infrastrukturas	0	0	0	0	2	0	0	0	2	1.10%
Ministria e Tregtisë dhe Industrisë	2	5	1	12	14	0	0	0	34	18.78%
Ministria e Pushtetit Lokal	0	0	0	3	4	0	0	0	7	3.87%
Ministria e Mbrojtjes	2	1	0	12	2	0	0	0	17	9.39%
Ministria e Financave	1	5	0	0	0	0	0	0	6	3.31%
Ministria e Shëndetësisë	1	16	0	0	3	0	0	0	20	11.05%
Ministria e Bujqësisë Pyltarisë dhe Zhvillimit Rural	0	1	0	0	9	0	0	0	10	5.52%
Ministria e Punës dhe	2	1	0	1	5	1	0	0	10	5.52%

Mireqenies Sociale										
Ministria e Ekonomise dhe Ambientit	1	2	1	1	6	0	0	0	11	6.08%
Ministria e Drejtesise	2	7	0	1	4	0	0	0	14	7.73%
Ministria per Kthim dhe Komunitete	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0.00%
Ministria e Puneve te Brendshme	0	1	1	5	7	0	0	0	14	7.73%
Ministria e Arsimit dhe Shkences	0	0	0	1	9	0	0	0	10	5.52%
Ministria e Puneve te Jashtme dhe Diaspores	1	0	0	0	0	0	0	0	1	0.55%
Ministira e Zhvillimit Rajonal	0	0	0	1	0	0	0	0	1	0.55%
<b>Totali</b>	<b>15</b>	<b>44</b>	<b>5</b>	<b>42</b>	<b>69</b>	<b>3</b>	<b>3</b>	<b>0</b>	<b>181</b>	
<b>Ne perqindje</b>	<b>8.29%</b>	<b>24.31%</b>	<b>2.76%</b>	<b>23.20%</b>	<b>38.12%</b>	<b>1.66%</b>	<b>1.66%</b>	<b>0.00%</b>		




Figura 1. Paraqitja grafike e statistikave sipas institucioneve qendrore

#### 4. Platforma online për konsultimet publike/ <https://konsultimet.rks-gov.net/>

Zyra për Qeverisje të Mirë në Zyrën e Kryeministrit në platformën online për konsultimet me publikun gjatë vitit 2020 ka punuar në përditësimin e të dhënave për institucionet e edhe për koordinatorët përgjatë gjithë kohës së pandemisë si dhe ndryshimit të vendimeve të Kuvendit për institucionet qeveritare, korrigjimin e platformës dhe mirëmbajtjen e saj me të dhëna të reja.

Është përgatitur një udhëzues për përdorimin e Platformës Online për Konsultimet Publike (tutorial) i cili u bën thirrje qytetarëve, përfaqësuesve të shoqërisë civile dhe publikut të gjerë që të përdorin Platformën Online për konsultime publike, por gjithashtu shpjegon se si ata mund të përfshihen në platformë dhe komentojnë.

ZQM/ZKM ka vazhduar të punoj në ndërtim të sistemit të konsultimeve publike edhe në nivelin lokal dhe për të akomoduar kërkesat për përfshirjen e komunave në proces të konsultimit. Në platformë gjatë vitit 2020 janë shtuar modulet e reja për secilën komunë, si dhe është ndërtuar sistemi i gjenerimit të statistikave edhe për nivel lokal.

## **5. Bashkëpunimi dhe ngritja e kapaciteteve për zyrtarët publik për konsultimet me publikun**

Gjatë vitit 2020 Zyra për Qeverisje të Mirë/Zyra e Kryeministrit kanë vazhduar bashkëpunimi me ministrinë, komunat dhe shoqërinë civile sa i përket mbarëvajtjes dhe përmirësimit të procesit të konsultimeve publike. Ministrive dhe jo vetëm, por edhe Komunave, ju është ofruar mbështetje e vazhdueshme nga ana e Zyrës për Qeverisje të Mirë përmes informatave të përditshme, përgjigje dhe sqarime siç është kërkuar nga ata.

Zyra për Qeverisje të Mirë/Zyra e Kryeministrit në bashkëpunim me Institutin e Kosovës për Administrata Publike dhe me përkrahjen e projektit të AT të BE-së, gjatë 2020 kanë organizuar dhe ofruar Programin e trajnimit të trajnerëve (ToT) për konsultimet publike. Ky program është ofruar për zyrtarë të institucioneve publike dhe ka pasur synim të krijojnë një grup të trajnerëve që IKAP-i në të ardhmen do ti angazhoj si trajner për ngritje kapacitetesh për zyrtarë tjerë në institucione publike në fushën e konsultimeve me publikun.

Në shtator 2020, Zyra për Qeverisje të Mirë/Zyra e Kryeministrit në bashkëpunim me Institutin e Kosovës për Administrata Publike, pas procedurave të vlerësimit nga Komisioni, kanë organizuar ceremoni për ndarjen e certifikatave për ToT për konsultimet me publikun. Me këtë rast janë certifikuar 10 (dhjetë) Trajner për konsultimet me publikun.

Në këtë mënyrë, do të sigurohet qëndrueshmëria e aktiviteteve për ndërtimin e kapaciteteve të ndërmarra vitet e kaluara me mbështetjen e projektit të asistencës teknike të BE-së. Për më tepër, zbatimi i programit ToT do të japë shtysë shtesë në përmbushjen e indikatorëve të Ndihmës Sektoriale Buxhetore për administratën publike në Kosovë.

Në dhjetor 2020, Zyra për Qeverisje të Mirë/Zyra e Kryeministrit me mbështetje të OSBE-së ka organizuar Punëtorinë “Merr pjesë edhe ti” Konsultimet me publikun dhe gjithë përfshirja – përmirësim i procesit në vendim marrje për politika dhe legjislacion. Qëllimi i punëtorisë ishte që bashkë me Organizatat e shoqërisë civile të diskutojmë për: rëndësinë e gjithë përfshirjes dhe

konsultimeve me publikun, rolin e shoqërisë civile në procesin e konsultimeve si dhe mundësitë e shoqërisë civile për përfshirjen në politikë bërje dhe legjislacion.

## **6. Koordinimi dhe mbarëvajtja e procesit të konsultimeve në kuadër të institucioneve**

Koordinimi dhe bashkëpunimi i brendshëm në kuadër të institucioneve qendrore e lokale shihet dhe vlerësohet si një sfidë sa i përket mbarëvajtjes së procesit të konsultimeve publike.

Me qëllim të përmirësimit të mëtejshëm të qasjes, koordinimit më të mirë ndërinstitucional për procesin e konsultimeve dhe platformës online për konsultimet me publikun Zyra për Qeverisje të Mirë/Zyra e Kryeministrit me mbështetje të OSBE-së, në dhjetor 2020 ka realizuar punëtori të përbashkët online me Koordinatorët për konsultime.


Gjithashtu në dhjetor 2020, ZQM/ZKM në bashkëpunim me IKAP është realizuar trajnim për shërbyes civile nga niveli qendror e lokal për konsultimet me publikun dhe platformën online për përfshirje në e publikut në politikë bërje. Në këtë trajnim është prezantuar sistemi dhe metodologjia e konsultimeve me publikun, rregullorja, platforma dhe monitorimi e raportimi për rrjedhën e konsultimeve me publikun.

Zyra për Qeverisje të Mirë/Zyra e Kryeministrit po vazhdon me fushatën informuese për Platformën për konsultimet me publikun. Udhëzuesi dhe video promovuese për përdorimin e Platformës Online për Konsultime Publike po ndahen jo vetëm nëpërmes platformës, por edhe përmes rrjeteve sociale e publikimeve në portalet ditore.

## **7. Numri i përgjithshëm i projekt dokumenteve**


Gjatë periudhës janar-dhjetor 2020 Qeveria e Republikës së Kosovës ka finalizuar konsultimin për 181 dokumente të cilat hyjnë në kategorinë e dokumenteve që sipas Rregullores hartuesit të tyre e kanë për obligim ti konsultojnë me publikun (figura 4).

Figura 2: Numri i dokumenteve te konsultuara (2020)



Nga këto dokumente 181 kanë qenë të publikuara në platformën e konsultimeve ndërsa tri dokumente janë konsultuar vetëm përmes metodave tjera të konsultimit.

Figura 3: Numri i dokumenteve sipas kategorive (2020)




- Numri më i madh i dokumenteve të cilat janë hartuar gjatë vitit 2020 i përket kategorisë së akteve nënligjore. Nga fillimi i vitit 2020 deri në fund të vitit 2020 raportohet se janë hartuar 184

dokumente, ku 181 dokumente kanë qenë për konsultim publik në platformën online dhe tri dokumente që janë aprovuar në qeveri e të cilat nuk kanë qenë në platformën për konsultime. Prej tyre 16 koncept dokumente, 44 draft ligje, 2 strategji, 4 programe, 6 plane veprimi, 42 draft rregullore dhe 70 udhëzime administrative.

## **8. Shkalla e plotësimit të standardeve minimale**

Numri i dokumenteve të cilat i janë nënshtruar konsultimit më publikun është pothuajse 100%. Plotësimi i standardeve minimale të procesit të konsultimeve publike shprehur në përqindje gjatë vitit 2020 është 64.09% e dokumenteve i plotësojnë standardet dhe 35.91% nuk i plotësojnë standardet e konsultimit.

*Figura 4: Shkalla e plotësimit të standardeve*



- Ministritë të cilat kanë plotësuar standardet plotësisht janë: Ministria e Mbrojtjes, Ministria e Pushtetit Lokal, Ministria e Tregtisë dhe Industrisë dhe Ministria e Drejtësisë.
- Ministritë që nuk kanë pasur asnjë dokument për konsultime me publikun gjatë vitit 2020 ka qenë Ministria për Komunitetet dhe Kthim.



## 09. Metodatat e përdorura gjatë procesit të konsultimeve

Sipas informatave të raportuara nga ministrinë dhe Zyra e Kryeministrit dhe ato të nxjerra nga Platforma elektronike e konsultimeve publike 181 dokumentet gjatë vitit 2020 janë publikuar në platformë dhe tri nuk janë publikuar. Përveç publikimit në platformë, është raportuar se gjatë procesit të konsultimeve publike gjithsejtë kanë marrë pjesë 1021 pjesëmarrës. Nga këta pjesëmarrës gjithsejtë janë bërë 1898 komente qoftë përmes takimeve, grupeve të punës apo edhe me shkrim.

## 10. Numri dhe statusi i komenteve

Gjatë vitit 2020 në platformën për konsultimet me publikun janë publikuar 181 dokumente. Tri dokumente nuk janë konsultuar përmes platformës për konsultimet me publikun. Prej 184 dokumenteve 93 dokumente janë konsultuar edhe përmes komunikimit zyrtar në platformë dhe 91 dokumente janë konsultuar edhe nëpërmes takimeve të punës. Prej 181 dokumenteve 148 dokumente sipas raporteve kanë marrë kontribut apo janë komentuar nga publiku përmes platformës. Gjithsejtë janë bërë 1898 komente qoftë përmes takimeve, grupeve të punës apo edhe me shkrim. Llogaritet se 961 komente janë pranuar plotësisht nga hartuesit e dokumenteve, 463 komente janë pranuar pjesërisht dhe 474 komente janë refuzuar apo nuk janë pranuar nga institucionet hartuese.

Figura 5: Numri dhe statusi komenteve (2020)





Figura 6: Ndarja e dokumenteve sipas komenteve ne platforme




Shumë nga komentet në platformë janë ofruar përmes dokumenteve të bashkëngjitura të cilat në një dokument përmbajnë një numër më të madh të komenteve sesa ato që gjenerohen automatikisht në seksionin e statistikave. Ndërsa numri i komenteve të llogaritura në këtë raport bazohet në informatat zyrtare të ofruara nga ana e koordinatorëve të konsultimeve publike në ministri (figura 7).

Tabela 3: Përmbledhje e llojeve të dokumenteve të publikuara sipas aktivitetit të bashkëpunëtorëve - Data: 01.01.2020-31.12.2020

Përmbledhje e llojeve të dokumenteve të publikuara sipas aktivitetit të bashkëpunëtorëve - Data: 01.01.2020-31.12.2020				
Institucioni	Me komente (kontribute nga bashkëpunëtorët)	Pa komente (kontribute nga bashkëpunëtorët)	Totali	Ne përqindje ne raportin (Me komente / Pa komente)
Zyra e Kryeministrit	3	12	15	8.29%
Ministria e Kulturës Rinise dhe Sportit	0	9	9	4.97%
Ministria e Infrastruktures	1	1	2	1.10%
Ministria e Tregtise dhe Industrise	3	31	34	18.78%
Ministria e Pushtetit Lokal	5	2	7	3.87%
Ministria e Mbrojtjes	0	17	17	9.39%

Ministria e Financave	2	4	6	3.31%
Ministria e Shendetesise	1	19	20	11.05%
Ministria e Bujqesise Pylltarise dhe Zhvillimit Rural	1	9	10	5.52%
Ministria e Punes dhe Mireqenies Sociale	2	8	10	5.52%
Ministria e Ekonomise dhe Ambientit	0	11	11	6.08%
Ministria e Drejtesise	4	10	14	7.73%
Ministria per Kthim dhe Komunitete	0	0	0	0.00%
Ministria e Puneve te Brendshme	0	14	14	7.73%
Ministria e Arsimit dhe Shkences	2	8	10	5.52%
Ministria e Puneve te Jashtme dhe Diaspores	0	1	1	0.55%
Ministira e Zhvillimit Rajonal	0	1	1	0.55%
<b>Totali</b>	<b>24</b>	<b>157</b>	<b>181</b>	
<b>Ne perqindje</b>	<b>13.26%</b>	<b>86.74%</b>		

Figura 7: Komentet sipas ministrive



Në grafikun më sipër pasqyrohen informatat krahasuese sipas ministrive për numrin e dokumenteve të konsultuara, numrit të pjesëmarrësve dhe numri i komenteve. Vlen të theksohet se pjesëmarrja e publikut në procesin e konsultimeve sipas të dhënave ndryshon nga ministria në ministri.

Volumi i aktiviteteve të ministrive për procesin e konsultimit gjatë vitit 2020 patjetër që dallon nga viti paraprak. Pasë parasyshë kohën e pandemisë dhe mos mundësisë së realizimit të takimeve dhe punëtorive me OSHC-të e publikun, qëllimi kryesor i institucioneve ka qenë që gjatë vitit 2020 të informohen sa më shumë që është e mundur publiku dhe OSHC-të për dokumentet që po hartohen dhe që ata të përfshihen në proces të hartimit dhe konsultimit të tyre. Gjithmonë për të siguruar rritjen e numrit të dokumenteve që i plotësojnë standardet dhe përmirësimi i cilësisë së konsultimeve.

**Kualiteti i konsultimit** – Edhe këtë vit metodologjia e përdorur për hartimin e këtij raporti dhe burimet e alokuara nuk ofrojnë mundësinë për të bërë vlerësimin e plotësimin të standardeve nga aspekti

